



03 -11- 2017



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Nr./Br. 2179-2017

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 106.1, 106.3 dhe 106.4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe nenin 26 të Ligjit nr. 03/L-072 të për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 03.11.2017, nxjerrë këtë:

## VENDIM

### Për Certifikimin e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale 2017 për Kryetar Komune në Mamushë


- I. Pas përfundimit të të gjitha procedurave në Vendvotime dhe në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve si dhe kur të gjitha vërejtjet e dala që u përkasin votimit dhe numërimit janë vendosur nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) dhe nga Gjykata Supreme, **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Certifikon Rezultatet Përfundimtare të Zgjedhjeve për Kryetar Komune në Mamushë të mbajtura me datën 22 tetor 2017, si në vijim:**
- II. **Për Kryetar Komune në Mamushë është zgjedhur Abdulhadi Krasnic nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Parisi – KDTP me 1.393 vota në përqindje prej 53,99 % të votave.**
- III. Rezultatet e Zgjedhjeve si në pikën I i janë bashkangjitur këtij Vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij. Po ashtu këto rezultate janë përfundimtare dhe detyruese.
- IV. Obligohet Sekretariati i KQZ-së që t'i publikojë në formë tabelare rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve në pajtim me këtë vendim.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi me 03.11.2017.

Prishtinë, 03.11.2017

Valdete Daka

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

## Mamushe/Mamusha



■ ABDÜLHADİ KRASNIÇ	54.0%
■ ARİF BÜTÜÇ	43.8%
■ RİZA KRUEZİ	2.3%
Total:	100.0%

Mamushe/Mamusha				
Emri/ Ime	Mbiemri/ Prezime	Emri i Partisë / Naziv Partje	Votave/Glasova	Përqindja/ Procentat
ABDÜLHADİ	KRASNIÇ	22 KDTP - KOSOVA DEMOKRATIK TÛRK PARTISI	1,393	53,99%
ARİF	BÜTÜÇ	95 KTAP - KOSOVA TÛRK ADALET PARTISI	1,129	43,76%
RİZA	KRUEZİ	20 RİZA KRUEZİ	58	2,25%